



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:013106

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05522998

C.nr.581/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.(R.) C. nga K., .”, p.nr, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Amir Rudaku avokat nga Gjilani, kundër të paditurës K. e Gj., me objekt kontesti padi për kthimin e paluajtshmërisë apo kompensimin e dëmit, jashtë seance, më datë 22.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e paditësit I. (R.) C. nga K., e paraqitur ndaj të paditurës K. e G.t, me objekt kontesti padi për kthimin e paluajtshmërisë apo kompensimin e dëmit.

A r s y e t i m

Paditësi ka parashtruar padi në këtë gjykatë më datë 29.02.2024, kundër të paditurës K.e Gj., lidhur me çështjen kontestimore, kthimin e paluajtshmërisë apo kompensimin e dëmit.

Gjykata me aktvendimin C.nr.581/2024 të datës 13.02.2024 e ka ftuar paditësin që në afat prej 15 ditësh ta paguajë taksën gjyqësore për vlerën e kontestit, duke e njoftuar të njëjtin edhe për pasojat ligjore në rast të mos veprimit sipas aktvendimit të kësaj gjykate, e më decidivisht si në këtë aktvendim.

Paditësi, edhe përkundër faktit se aktvendimin e sipërcekur e ka pranuar më datë 15.02.2024 (ku shihet nga fletë kthesa për dorëzim personal) e njëjta nuk ka vepruar, respektivisht nuk e ka plotësuar padinë, andaj gjykata bazuar në nenin 102.3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), *padinë e paditëses e ka konsideruar të tërhequr.*

Nga të cekurat, dhe në bazë të nenit 142 dhe 102.3 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

C.nr.581/2024, me datë 22.03.2024

Gjyqtarja,  
Florije Qerimi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.